

Data 19/12/2022

PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, SHËRBIME)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “IMPLEMENTIMI SISTEMIT TË MONITORIMIT TË INFRASTRUKTURAVE IT NË KESH SH.A DHE LËVRIMI I LICENSAVE SOFTWARE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të tjera -98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: **11,000,000 (Njëmbëdhjetëmilion) Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklarimet” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,

autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklaratimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklaratimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

b) ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”;

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Çertifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për shitjen e shërbimit të zgjidhjes së Sistemit të Monitorimit, dhe Licencave AutoCAD dhe Adobe.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi: Kjo kërkesë, garanton Ak-në se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të shërbimeve të kërkuara në cilësinë dhe standartet e kërkuara në termat e referencës. Kjo kërkesë i

shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

1.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjësit e mëposhtëm

- 1) Minimalisht 1(një) udhëheqës projekti të diplomuar në shkenca kompjuterike/elektronike, të çertifikuar me çertifikat PMP ose ekuivalent.
- 2) Minimalisht 1(një) specialist të çertifikuar për pajisje storage, të lëshuar nga prodhuesi ose autoritete çertifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi.
- 3) Minimalisht 1(një) specialist të çertifikuar për pajisje servera, të lëshuar nga prodhuesi ose autoritete çertifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi.
- 4) Minimalisht 1(një) punonjës të çertifikuar për network.
- 5) Minimalisht 1(një) specialist të çertifikuar në nivel profesional ose të avancuar për konceptet e routing dhe switching, të çertifikuar nga prodhues të pajisjeve të rrjetit ose autoritete çertifikuese të njohura zyrtarisht nga prodhuesi.
- 6) Minimalisht 1(një) specialist të çertifikuar në nivel profesional ose të avancuar për sigurinë në rrjeta të çertifikuar nga prodhues ose autoritete çertifikuese të njohura zyrtarisht nga prodhuesi.

Sqarim:

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një çertifikatë.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Çertifikatat e mësipërme të vlefshme:

Argumentim: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure.

Konkretisht:

1(Një) udhëheqës projekti të diplomuar në shkencë kompjuterike/elektronike- është kërkuar ky punonjës nisur nga rëndësia e këtij projekti. Nevojitet një menaxhim sa më i mirë i strategjive që do të përdoren për ecurinë sa më të mirë të zbatimit të këtij projekti.

1(Një) specialist të certifikuar për pajisje storage- është kërkuar ky punonjë pasi në projekt do të ketë monitorime të infrastrukturave që përmbajnë pajisje storage. Është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e propozuar të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për këto pajisje. Sistemi i monitorimit do të kërkojë konfigurime specifike për pajisjet storage për ti integruar në platformën e monitorimit. Këto konfigurime mund të jenë komplekse dhe nuk duhet të cenojnë disponueshmërinë në rrjet të pajisjeve storage të cilat mund të sjellin problematika në shërbimet kritike që KESH disponon.

1(Një) specialist të certifikuar për pajisje servera- është kërkuar ky punonjë pasi në projekt do të ketë monitorime të infrastrukturave që përmbajnë pajisje servera, është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e propozuar të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për këto pajisje. Sistemi i monitorimit gjithashtu do të ketë të domosdoshme të monitoroj infrastrukturën server të të gjithë korporatës, përfshi këtu edhe infrastrukturën kritike të prodhimit të energjisë. Sikurse KESH përdor pajisje server të markave prestigjioze nevojitet dëshmia e aftësisë teknike për këto konfigurime të cilat do të duhet të realizohen në pajisje për të dërguar të dhëna monitorimi tek sistemi që po kërkohet të zhvillohet.

1(Një) punonjës të certifikuar për network- është kërkuar ky punonjë pasi projekti parashikon monitorime të infrastrukturave të rrjeteve IT. Është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e propozuar të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për network. Sistemi i monitorimit kryesisht bazohet në rrjetin informatik (network). KESH në infrastrukturën e saj përdor pajisje të ndryshme të rrjetit nga prodhues të ndryshëm të mirënjohur në treg. Ky sistem do të përdoret rrjetin për të komunikuar me të gjitha infrastrukturën e kompanisë, për pasojë është shumë i rëndësishëm demonstrimi i aftësive profesionale në këtë fushë.

1(Një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose të avancuar për konceptet e routing dhe switching –këta specialist, garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i kualifikuar dhe ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për të realizuar me sukses monitorimin e infrastrukturave të rrjetit. Niveli profesional i kërkuar garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Rrjeti informatik i KESH, për shkak të kompleksitetit dhe ruajtjes së sigurisë kibernetike bazohet në rrjet të komplikuar të organizuar në pajisje router, switch të niveleve të ndryshme të përcjelljes. Këto pajisje janë baza kryesore e komunikimit që sistemi i monitorimit do të përdoret për patur një qasje të pastër të infrastrukturës në teresi dhe monitorim sa më efikas të aktivitetit.

1(Një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose të avancuar për sigurinë në rrjete- operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar, me njohuri të certifikuar dhe ekspertizën e duhur profesionale për monitorimin e pajisjeve të rrjetit në pajisje të tilla të nivelit firewall etj. KESH disponon gjithashtu pajisje specifike firewall të cilat vendosen në ndarjet kryesore të rrjeteve, midis rrjetit administrativ, atij të prodhimit gjenerimit dhe sigurisë. Duke qenë se këto pajisje janë muri kryesor mbrojtës për komunikimet me jashtë kompanisë përfaqësojnë një pikë kyçe për sistemin e monitorimit, si të tilla nevojiten konfigurime specifike për të shtuar një sistem monitorimi të cilat mund të cenojnë sigurinë kibernetike në rastet kur realizohen nga personel jo i specializuar.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Rrjeti i sotëm, në Korporaten Elektroenergjitike Shqiptare, është më kompleks se kurrë më parë dhe mbrojtja e saj nga sulmet keqëdashëse dhe të sofistikuar është një detyrë shumë kritike. Gjithashtu infrastruktura është kritike dhe e rëndësishme për tu monitoruar në kohë reale nga sisteme të cilat suportojnë teknologji të lartë dhe adaptive në integritet me furnitorë të ndryshëm të paisjeve. Duke qenë se platforma e monitorimit që kërkohet të zbatohet do të përdoret nga DATIK për nevojat monitorimi 24/7 për përgatitjen e specifikimeve teknike janë përdorur terma reference të bazuara në koncepte të ITIL, sisteme monitorimi të bazuara në ndërfaqe WEB për praktikitet si dhe të cilat ofrojnë databaza ku do të ruhen të gjithë alarmet që paisjet e lidhura do të gjenerojnë. Gjithashtu duke qenë se sistemi nevojitet të shfaqet diku nga ku do të vëzhgohet nga stafi i mirëmbajtjes DATIK, është përshkruar me specifikat e vlerësuara të mjaftueshme për të patur pamje të lexueshme nga distanca e parashikuar në zyrë si dhe nga stafi i IT. Procedura kërkon të lëvrohen edhe licenca për programe të nevojshme për stafin inxhinierik për punët e përditëshme sipas pozicioneve të punës. Sipas punës që realizojnë në departament, kryesisht inxhinieret e gjenerimit, të sigurisë së digave dhe mirëmbajtjes e kanë të nevojshme përdorimin e aplikimeve specifike Autocad të specializuara për punimet inxhinierike e dizajnimet që ata bëjnë. Gjithashtu kërkohet lëvrime të licensave për acrobat PDF për punime profesionale sipas nevojave dhe kërkesave nga departamentet.

Njësia e Prokurimit